

UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

VENDIM

Nr. 34 , datë 29/09/2020

MBI

**“MIRATIMIN PARAPRAK, PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË
CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË BACHELOR
“FOTOGRAFI”, TË PARAQITUR NGA DEPARTAMENTI I ARTEVE TË
APLIKUARA, PRANË FAKULTETIT TË ARTEVE TË BUKURA NË
UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 41, datë 24/01/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” (i ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18/12/2019); Udhëzimin e MASR nr. 1, datë 14/01/2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë”; Vendimin e Senatit Akademik nr. 39, datë 25.09.2020 “Mbi miratimin paraprak, për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor ‘Fotografi’, të paraqitur nga Departamenti i Arteve të Aplikuara, pranë Fakultetit të Arteve të Bukura”; si dhe në shkresën e datës 25.09.2020, të Kryetarit të Senatit Akademik të Universitetit të Arteve, Prof. Kastriot Çausi, me lëndë “Përcjellje të Vendimeve të Senatit Akademik”, drejtuar Bordit të Administrimit të UART dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi dokumentacionin e paraqitur nga FAB, me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Miratimin paraprak të dokumentacionit për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor ‘Fotografi’, të paraqitur nga Departamenti i Arteve të Aplikuara, pranë Fakultetit të Arteve të Bukura në Universitetin e Arteve, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim të dërgohet për miratim përfundimtar pranë MASR, sipas Pikës 4, Kreut VI të Udhëzimit nr. 1, datë 14/01/2020 nga Përgjegjësi i Njesisë Bazë të Arteve të Aplikuara, në Fakultetin e Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve
4. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe te transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Risena Xhaja (Kryetar)

Prof. Besnik Bisha (Anëtar)

Prof. Arben Basha (Anëtar)

Aida Martiro (Anëtar)

Prof. Bujar Kapexhiu (Anëtar)

Lorenc Vangjeli (Anëtar)

Vladimir Llakaj (Anëtar)